

## KOMUNA E KAÇANIKUT 2017: PROBLEMET KRYESORE DHE TRENDET BUXHETORE

### Hyrje

Kaçaniku udhëhiqet nga Besim Ilazi i cili përfaqëson Partinë Demokratike të Kosovës. Ky është mandati i tij i parë. Në zgjedhjet e fundt për kryetar të komunës (nëntor 2013), Ilazi ka fituar në raundin e parë duke siguruar 53% apo 8,056 vota.<sup>1</sup>

Hulumtimet tregojnë se qytetarët e Kosovës kanë njohuri të mjaftueshme mbi ndarjen e kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe lokal.<sup>2</sup> Sipas një studimi të UNDP-së, 93% e qytetarëve të Kaçanikut konsiderojnë se komuna mund t'i zgjidhë problemet me të cilat ballafaqohen ata.<sup>3</sup> Dy vite pas nisjes së mandatit të kryetarit Ilazi 47% e qytetarëve janë shprehur të kënaqur me punën e tij, përderisa vetëm 20% e qytetarëve kanë konsideruar se fondet publike në komunë menaxhohen siç duhet.<sup>4</sup>

Në prag të zgjedhjeve lokale 2013, Instituti GAP kishte identifikuar problemet kryesore të Komunës së Kaçanikut. Ndër problemet më madhore kishin dalë të jenë: Mungesa e ujësjellësit, menaxhimi me mbeturina, mungesa e kanalizimeve, ndotja e lumenjve, ndotja e ajrit, mungesa e mureve mbrojtës në rrugët malore.<sup>5</sup>

---

<sup>1</sup> Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Rezultatet për Kryetarë Komune 2013. Burimi: <http://bit.ly/1d30foS> (Hapur më 18 qershor 2017)

<sup>2</sup> Instituti GAP, Adresimi i Përgjegjësisë: Njohuritë e qytetarëve me kompetencat e komunave. Maj 2017. Burimi: <http://bit.ly/2os7GPU>

<sup>3</sup> UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 37. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

<sup>4</sup> UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 91 & 92. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

<sup>5</sup> Instituti GAP. Problemet Kryesore dhe trendet buxhetore të Komunës së Kaçanikut 2013. Burim: <http://bit.ly/2sxxJqh> (Qasur me 18.05.2017)

## Problemet aktuale të Komunës së Kaçanikut

### **Mungesa e ujit në një zonë të qytetit dhe gypat nga azbesti.**

Zona e Kaçanikut të vjetër ka mungesë të ujit të pijes. Reduktimet në këtë zonë gjatë një dite shkojnë deri në dhjetë orë, kurse gjatë verës kohëzgjatja e reduktimeve mund të jetë edhe më e madhe. Problem i veçantë është edhe gypi kryesor që përshkon qytetin, ai është nga materiali i azbestit dhe kësaj paraqet rrezik për shëndetin e qytetarëve. Në fshatra, në pjesën më të madhe të tyre ka mungesë të rrjetit të ujësjesit.<sup>6</sup>

### **Ndotja e lumenjve**

Ky problem daton edhe nga zgjedhjet lokale të nëntorit 2013. Lumi "Nerodime" i cili kalon në mes të qytetit kundërmon për arsye të derdhjes së kanalizimit në të. Në të njëjtën gjendje ndodhet edhe lumi "Lepenc". Që në të dy këta lumenj derdhen mbeturina përgjatë gjithë rrjedhës së tyre, në përjashtim të zonës së qendrës së qytetit, ku nuk shihen mbeturina, por megjithatë duken gypat e kanalizimeve të cilat i sjellin në lum ujërat e zeza. Banorët e Kaçanikut të vjetër dhe Stagovës, fshatra në të cilat kalon lumi "Nerodime", ankohen për kundërmim të lumit pasi që përveç ndotjes nga fshatrat e Kaçanikut derdhen edhe kanalizimet e disa prej fshatrave të komunës së Ferizajt. Gjatë periudhës së verës, banorët nuk mund të hapin dritaret e shtëpive nga era e keqe e lumit.

### **Prezenca e madhe e qenëve endacak.**

Në komunën e Kaçanikut janë adresuar kërkesa të shumta me qëllim të zgjidhjes së problemi të qenëve endacak. Ky problem i shqetëson veçmas banorët e zonës së Dushkajës së Kaçanikut, ku pjesa më e madhe e nxënëseve filloristë kalojnë nëpërmjet kësaj lagje për të shkuar në shkolle. Rastet e kanosjes së fëmijëve nga qentë endacak janë të raportuara edhe në polici.

### **Mungesa e ndriçimit publik.**

Në lagjen "Dushkaja" të Kaçanikut mungon ndriçimi publik. Ndriçimi publik mungon edhe në afërsi të gjimnazit "Skënderbeu". Gjithashtu, ndriçimi publik mungon në të gjitha fshatrat e komunës së Kaçanikut.

---

<sup>6</sup> Problemet nëpër komuna janë listuar bazuar në intervista të drejtpërdrejta me përfaqësues komunal, të partive politike, shoqërisë civile, mediave dhe njohëseve të qeverisjes lokale.

### **Dëmtimi i rrugës.**

Janë disa rrugë në Komunën e Kaçanikut si në fshatin Doganaj, fshatin Elezaj si dhe rruga katër kilometra Gajre-Ivajë të cilat pothuajse janë të pakalueshme. Dëmtimi ka ardhur nga ekskavatorët e kompanisë "Bechtel Enka". Komuna nuk ka marrëveshje me këtë kompani për rregullimin e dëmeve të shkaktuara.

### **Dëmtimi i shkollës së mesme profesionale.**

Shkolla e mesme profesionale në Kaçanik ka nevojë për riparime të gjera. Gjashtë klasë në këtë shkollë nuk mund të shfrytëzohen shkak të dëmtimeve të shumta e që paraqesin rrezik nga shembja. Komuna ka planifikuar disa herë riparimin e saj por mjetet e dedikuara janë rialokuar në projekte të tjera.

## **Fushave që komuna duhet t'u kushtojë vëmendje**

### **Ndërtimi i terreneve sportive**

Pjesa me e madhe e shkollave në komunën e Kaçanikut nuk kanë terrene të hapura sportive. Përveç kësaj edhe në zonat tjera publike mungojnë hapësirat e tilla. Komuna do të duhet në katër vitet e ardhshme të planifikojë ndërtimin e këtyre hapësirave.

### **Ndriçimi i pjesës së poshtme të lumit dhe urës**

Qendra e qytetit të Kaçanikut përshkohet nga lumi i rrjedhshëm dhe ura e vjetër e qytetit (në afërsi të kalasë). Komuna do të duhet t'i kushtonte më shumë vëmendje sistemit të ndriçimit publik, veçmas në këtë zonë.

## **Trendet buxhetore në Komunën e Kaçanikut (2017)**


Komuna e Kaçanikut në vitin 2017 ka planifikuar rreth 7 milion euro buxhet.<sup>7</sup> Krahasuar me buxhetin e planifikuar të vitit 2013, Komuna e Kaçanikut ka pasur një rritje afro 1.4 milion euro të buxhetit. Në buxhetin e këtij viti do të barten edhe rreth 141 mijë euro tjera nga të hyrat vetanake të pashpenzuara,<sup>8</sup> ndërsa në vitin 2013 janë bartur rreth 174 mijë euro, pra 30 mijë euro më shumë.<sup>9</sup>

<sup>7</sup> Shih për më shumë platformën buxhetore të Institutit GAP në <http://bit.ly/2rMELbD>

<sup>8</sup> Ministria e Financave, Raporti vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016. Burimi: <http://bit.ly/2eFtgKj>, faqe 63


<sup>9</sup> Ministria e Financave, Raporti vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2012. Burimi: <http://bit.ly/2wKArjf>, faqe 60

**Figura nr.1:** Buxheti i Komunës së Kaçanikut 2017



Në bazë të grafikonit të mëposhtëm shohim se Komuna e Kaçanikut vazhdimisht ka shpenzuar më së shumti për paga dhe mëditje dhe trendi ka shkuar në rritje, përderisa investimet kapitale kanë pasur lëvizje të ndryshme, por krahasuar me vitin zgjedhor paraprak, Kaçaniku ka rritje në këtë kategori.

**Figura nr.2:** Trendët buxhetore në komunën e Kaçanikut 2013 dhe 2017




Kategoria e pagave dhe mëditjeve ka qenë rreth 3.7 milionë euro në 2013, ndërkaq është rreth 4.8 milionë euro në 2017. Rritja prej pothuajse një milioni mund t'i atribuohet vendimit të kryeministrit

në vitin 2014 për rritjen e pagave në sektorin publik për 25%<sup>10</sup> si dhe të punësimit të dy punëtorëve më shumë sesa në vitin 2013. Komuna e Kaçanikut po ashtu ka kontraktuar edhe rreth 11 punëtorë të tjerë me kontrata për shërbime të veçanta në 2017.

Në kategorinë e investimeve kapitale të planifikuara, Vitia ka pasur rritje për rreth 232 mijë euro, por pjesëmarrja në buxhetet totale të viteve zgjedhore, pra 2013 dhe 2017, mbetet me përqindje të njëjtë (69%). Kategoria e shpenzimeve komunale është rritur dhe e mallrave dhe shërbimeve është zvogëluar, por pjesëmarrja në buxhet mbetet me përqindje të njëjtë për të parën dhe me rënie për 2 pikë përqindjeje për të dytën kur krahasojmë këto dy vite zgjedhore. Kategoria e subvencioneve dhe transfereve është rritur për afro 74 mijë euro dhe pjesëmarrja në buxhetin total të komunës është rritur për një pikë përqindjeje që nga viti 2013.


**Figura nr.3:** Përqindja e pagave dhe investimeve kapitale në buxhetin e vitit 2017



Komuna e Kaçanikut mund të konsiderohet se ka të hyra mesatare komunale ku gjatë vitit 2016 ka grumbulluar 633 mijë euro të hyra të cilat janë 229 mijë euro më shumë se në vitin 2013.

<sup>10</sup> Zyra e Kryeministrit, Vendimet e mbledhjes së 172-të të qeverisë. Burimi: <http://bit.ly/2w6MK0M>

**Figura nr.4:** Të hyrat komunale në 2016 sipas kategorive



Burimi. Zyra Kombëtare e Auditimit

## Rekomandime

Bazuar në problemet kryesore, fushat të cilat kërkojnë vëmendjen e Komunës dhe trendet buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës e dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të ndërmerret këto veprime:

- Komuna e Kaçanikut duhet të shtrijë rrjetin e ujësjellësit edhe në zonën e Kaçanikut të vjetër dhe të zëvendësojë gypat e ujit që konsiderohet të dëmshëm për shëndetin e qytetarëve.
- Komuna e Kaçanikut duhet të investojë në projekte të veçanta të ndriçimit publik, veçmas në shtratin e lumit të qytetit, të kalaja dhe të ura të vjetër.
- Komuna e Kaçanikut duhet të ndërmarrë masa disiplinore ndaj udhëheqësve të shkollave që nuk përkujdesen ndaj aseteve të shkollave.
- Komuna e Kaçanikut duhet të rris investimet në ndërtimin e terreneve sportive veçmas në zonat urbane.
- Komuna e Kaçanikut duhet të shoh me prioritet zhvillimin e jetës kulturore në qytet.

INSTITUTI GAP  
GAP INSTITUTE



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Ky projekt mbështetet nga:



**National Endowment  
for Democracy**

*Supporting freedom around the world*